



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 427/14**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha, Rafat Haxhaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesat e paraqitura nga kandidatja për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës Naile Alaj nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Deçan paraqitur kundër Rezultatit Përfundimtar të Publikuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Paralementare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, morri këtë :

**V E N D I M**

**REFUZOHEN si të pa bazuara** ankesat Anr. 427/2014, Anr. 428/2014, 429/2014 të datës 27.06.2014 të Naile Alaj kandidate për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e LDK-së dega në Deçan.

**Arsyetim**

PZAP-i, me datë 27.06.2014 në ora 13:34 ka pranuar ankesat nga Naile Alaj kandidate për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e LDK-së si:

- Në ankesën Anr.427/2014, pretendohet se në fshatin Irzniç të Komunës së Deçanit në Qendrën e Votimit QV 0106C përkatësisht në vendvotimin VV04R është bërë manipulimi i votave, pasi që iu janë bartur votat kandidatëve të tjerë dhe kjo dëshmohet në bazë të Formularit të Raportit të Vëzhguesve . Parashtruesja e ankesës ka shtuar se sipas dëshmitarëve ka pasur numër më të madhë të votave.
- Në ankesën Anr.428/2014, pretendohet se në fshatin Mushtisht në Qendrën e Votimit QV përkatësisht në vendvotimin VV nr.2 me rastin e bartjes së votave janë dëmtuar formularët, pasi që votat e saj janë bartur tek personat e tjerë. Parashtruesja e ankesës ka shtuar se këto pretendime i bazon në deklaratimet e vëzhguesve të këtij vendvotimi.
- Në ankesën Anr.429/2014, pretendohet se në fshatin Vrellë Komuna e Istogut në Qendrën e Votimit përkatësisht në vendvotimin nr.2 me rastin e bartjes së votave janë dëmtuar formularët, pasi që votat e saj janë bartur kandidatëve të tjerë nga radhët e subjektit politik. Parashtruesja e ankesës ka shtuar se këto pretendime i bazon në deklaratat e vëzhguesve të këtij vendvotimi.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimin të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërsëhënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

### **Ankesat janë të pa bazuara**

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të Naile Alaj kandidate për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik LDK janë të pa bazuara pasi që ankesat e saj nuk posedojnë asnjë dëshmi për ti vërtetuar pretendimet ankimore se është bërë ndonjë pa rregullsi siç ka potencuar se votat e saj janë bartur tek kandidatët tjerë, dhe se nuk e ka bërë asnjë përkrahim të hollësishëm se ku mund të gjenden dëshmitë. Prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së përcaktohet “PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet”, si dhe në bazë të nenit 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-së parashihet “hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit” lidhur me ankesat e lartë përmendura u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr.427/2014 më datën 30.06.2014



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*